

**Prioritetet e Reformave Urgjente  
më të ngadalshme se restaurimi  
i praktikave joreformuese!**

Janar 2016, Shkup

---

# МРЕЖА

# 23

Botues:  
Институт пѐр Политикѐ Evropiane (EPI) – Shkup

Пѐр botuesin:  
Dr. Malinka Ristevska Jordanova


Dizajni:  
Gaja Dizajn

Projekti “Rrjeti 23”: Monitorimi i Prioriteteve тѐ Reformave Urgjente mbѐshtetet nga Mbretѐria e Holandѐs. Opinionet e prezantuara нѐ кѐтѐ dokument janѐ opinionet тѐ autorѐve dhe nuk i pasqyrojnѐ чдоherѐ opinionet e donatorit.



Kingdom of the Netherlands

Оваа публикација е составен врз основа на мониторинг на имплементацијата на Итните реформски приоритети преку мрежа 23, вклучувајќи ги следниве членови на мрежата:



## **Përmbajtja**

Prioritetet e Reformave Urgjente më të ngadalshme se restaurimi i praktikave joreformuese .....	4
Çka janë Prioritetet e Reformave Urgjente? .....	4
Sundimi i së drejtës dhe gjygjësori .....	5
Depolitizimi i administratës publike .....	5
Reformat zgjedhore.....	5
Implementimi i rekomandimeve të Komisionit Anketues për Ngjarjet e 24 Dhjetorit .....	5
Media: liria e shprehjes .....	5
Si dhe në ç'masë implementohen Prioritetet e Reformave Urgjente .....	5
I Sundimi i së drejtës dhe gjygjësori.....	6
A) Gjygjësori .....	6
B) Mbikëqyrja funksionale gjyqësore dhe parlamentare mbi ndjekjen e komunikimeve .....	7
C) Organe të pavarura rregullatore dhe mbikëqyrëse .....	8
Ç) Politikat dhe legjislacioni i antikorrupsionit .....	8
D) Lustrimi .....	8
II DEPOLITIZIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE .....	8
III REFORMA ZGJEDHORE.....	9
IV IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT ANKETUES PËR NGJARJET E 24 DHJETORIT .....	9
V MEDIA: LIRIA E SHPREHJES.....	9
a) Servisi publik radiodifuziv .....	9
b) Reklamimi i Qeverisë .....	9
c) Qasja në informata .....	9
d) Shpifja .....	9
Çka është e rëndësishme, por nuk është cekur në mënyrë eksplicite në Prioritetet e Reformave Urgjente .....	10
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	11

## Prioritetet e Reformave Urgjente më të ngadalshme se restaurimi i praktikave joreformuese!

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Përzghinos, në muajin qershor të vitit 2015, katër partitë më të mëdha maqedonase – nënshkruese “ranë dakord t’i zbatojnë të gjitha rekomandimet e Komisionit Evropian, sa u përket çështjeve sistematike nga sundimi i së drejtës”. Në të vërtetë, partitë “symbyllas” i pranuan Prioritetet e Reformave Urgjente, para se të publikohen të njëjtat, në qershor të vitit 2015.

Strategjia e zgjerimit të Komisionit Evropian dhënie e sërishme të rekomandimit e ndërlihd me hapjen e negociatave për anëtarësim përmes zbatimit të “vazhdueshëm” të Marrëveshjes politike të 2 qershorit/15 korrikut dhe përmes “progresit të konsiderueshëm të implementimit të Prioriteteve të Reformave Urgjente”.<sup>1</sup>

Nëse opinioni publik e ka pak më të qartë se çka nënkupton implementimi i Marrëveshjes politike, shumë pak ose aspak nuk është e qartë çka nënkupton “progres i konsiderueshëm në implementimin e Prioriteteve të Reformave Urgjente” jo vetëm për opinionin publik më të gjerë, por edhe për ata që në mënyrë të drejtpërdrejt duhet t’i implementojnë. Në këtë mënyrë, ato shndërrohen në imagjinatë të paqartë kolektive, sa i përket domethënies së tyre, të presupozimeve dhe dyshimeve nëse pas këtij verdikti fshihet një shifër ose çelësi i veprimtimit konkret ose bëhet fjalë vetëm për një frazë të parëndësishme burokratike.

### Çka janë Prioritetet e Reformave Urgjente?

Prioritetet e Reformave Urgjente janë dokument të Komisionit Evropian, i cili i bashkëngjitet Raportit të ekipit të ekspertëve, i udhëhequr nga Rajnhard Pribe.<sup>2</sup> Edhe pse vet Raporti përmbante rekomandime, Komisioni i veçoi në një dokument të posaçëm, të cilit pastaj iu referua Strategjia për Zgjerim dhe Këshilli i Bashkimit Evropian në konkluzionet e tij, nga data 16 dhjetor të vitit 2015.<sup>3</sup>

Dokumenti është ndarë në 5 kapituj:

Sundimi i së drejtës dhe gjyqësorijurisprudenca,  
Depolitizimi i administratës publike,  
Reformat zgjedhore,  
Implementimi i rekomandimeve të Komisionit Anketues për Ngjarjet e 24 Dhjetorit.  
Media: liria e shprehjes.

Cila është risia e këtij dokumenti, në krahasim me rekomandimet paraprake të Komisionit?<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Strategjia e zgjerimit. Komisioni Evropian. 10.11.2015. E aksesshme në:

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_strategy\\_paper\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_strategy_paper_en.pdf)

<sup>2</sup> Rekomandime nga grupi i ekspertëve të lartë për çështje sistematike në lidhje me sundimin e së drejtës që kanë të bëjnë me ndjekjen e komunikimeve, të publikuara në pranverën e vitit 2015. Grupi i ekspertëve të pavarur në fushën e sundimit të së drejtës, me kërkesë të Komisionit Evropian. 8.6.2015. E aksesshme në:

[http://ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf)

<sup>3</sup> Konkluzionet e Këshillit të Ministrave për Punë të Përgjithshme të BE janë të aksesshme në:

<http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15356-2015-INIT/en/pdf>

<sup>4</sup> Përqendrohemi vetëm në rekomandimet e kumtuara publikisht nga Komisioni, kryesisht të përmbajtura në raportet e rregullta vjetore. Është mjaft e besueshme, se Komisioni Evropian në forma të ndryshme ia ka prezantuar Qeverisë (në kuadër të dialogut në trupat për zbatimin e MSA, Dialogu i Lartë Aderues, etj.), por ato nuk janë publikisht të aksesshme.

## Sundimi i së drejtës dhe gjyqësori

fokus i qartë i pavarësisë dhe cilësisë së drejtësisë;  
rekomandime konkrete lidhur me mbikëqyrjen gjyqësore dhe parlamentare të ndjekjes së komunikimeve;  
fokus më i madh i pavarësisë së organeve rregullatore dhe mbikëqyrëse;  
kërkesa më rigorozë të revizionit/ndërprerja e lustrimit.

Është më se evidente se në këtë fushë, rekomandimet bartin me vete më shumë “risi” që gjithsesi ka të bëjë me skandalin e zbuluar të përgjimeve dhe të dhënave të Raportit të Pribe, pikë referimi e të cilave është pikërisht ky skandal. Së këtejmi, “me dyer të hapura” parashtrohet çështja e mbikëqyrjes mbi komunikimet dhe roli i shërbimeve të zbulimit – çështje e cila është e pranishme në kontinuitet, por nuk ishte në plan të parë, veçanërisht në periudhën pas vitit 2008, kur mbikëqyrja parlamentare mbi shërbimet të niveleve të ndryshme, u pamundësua plotësisht

## Depolitizimi i administratës publike

■ Përveç retorikës së ashpër, sa i përket zbatimit të përpiktë të ligjeve të reja, prioriteti nuk sjell asgjë të re. Përkundrazi, (gabimisht) prioritetin e ndërlidh me zbatimin e ligjeve të reja, edhe pse të gjitha ligjet e deritanishme dhe ndryshimet e ligjeve u miratuan me qëllim të njëjtë – administratë publike profesionale dhe e depolitizuar, por deri më tani rezultati ishte i kundërt me qëllimet.

■ Kërkesa është konkrete sa i përket ndërprerjes së transformimit të kontratave të punës nga të përkohshme në të përhershme dhe publikimit të numrit të të punësuarve në sektorin publik.

## Reformat zgjedhore

■ Përsëriten rekomandimet nga raportet e Komisionit, duke iu referuar rekomandimeve të OSBE/ODIHR.

## Implementimi i rekomandimeve të Komisionit Anketues për Ngjarjet e 24 Dhjetorit

■ nuk ka rekomandime konkrete.

## Media: liria e shprehjes

■ Konkretizohen dhe sistematizohen rekomandimet paraprakisht të adresuara në lidhje me servisin radiodifuziv, reklamimin qeveritar, aksesin në informata dhe shpifjen.

Shumë nga prioritetet në të vërtetë përsëriten, prioritetet të përcaktuara nga vitet e kaluara. Pa përcaktimin e afateve të qarta për implementimin e tyre, përsëritja e tyre jo vetëm që nuk është efektive, por jep sinjale për tolerancë të pakufizuar në të ardhmen të praktikave të këqija. Së këtejmi, tolerancë e mëtutjeshme e mosimplementimit të prioritetëve nënkupton mbështetje të tërthortë të pushtetit sa u përket praktikave të këtilla.

## Si dhe në ç'masë implementohen Prioritetet e Reformave Urgjente?

Vlerësimi ynë, sa i përket realizimit të Prioriteteve të Reformave Urgjente, mbështetet mbi mbikëqyrjen e strukturuar, sipas një metodologjie të përcaktuar paraprakisht, në të cilën morën pjesë anëtarë të "Rrjetit 23".<sup>5</sup> U mbikëqyrën dhe analizuan informatat e institucioneve, të partive dhe të mediave, ndërkaq u mbikëqyrën edhe seancat e organeve dhe autoriteteve të caktuara, si dhe lëndët gjyqësore. Në bazë të mbikëqyrjes, në periudhën kohore nga 15 shtatori deri në 31 dhjetor të vitit 2015, u publikuan gjashtë raporte.<sup>6</sup> U organizuan tre forume, në të cilat u debatuan të dhënat dhe konstatimet.

Të dhënat dhe vlerësimi i realizimit të çdo prioriteti janë pasqyruar në infogramin e bashkëlidhur. Në vijim në mënyrë të detajuar do ta shqyrtojmë implementimin e çdo prioriteti.

## I Sundimi i së drejtës dhe gjyqësori:

### A) Gjyqësori

Nuk zbatohen prioritetet lidhur me depolitizimin e emërimit dhe avancimit të gjyqtarëve, vlerësimin e tyre, procedurat disiplinore dhe shkarkimin e tyre. Këshilli Gjyqësor, duke iu referuar Plan Veprimit (të pa publikuar), vazhdoi të zgjedh kryetarë të gjykatave dhe të shpallë konkurse për zgjedhjen e gjyqtarëve, pa kurrfarë ndryshime paraprake të sistemit të zgjedhjes. Krahas reagimeve të sektorit civil i cili vuri në dukje atë se Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurave për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit nuk është zgjidhje adekuate për zbatimin e rekomandimeve të GREKO,<sup>7</sup> vazhduan aktivitetet për kompletimin e tij. Përfundimisht, në dhjetor të vitit 2015, edhe Komisioni i Venecias, doli me vendim të vet,<sup>8</sup> edhe pse distancohet nga vlerësimi i kushtetutshmërisë të Ligjit me të cilin formohet ai organ, në mënyrë të qartë u prononcua se zgjidhja nuk është adekuate, por edhe se reformat në fushën e gjyqësorit kanë divergjenca nga ndërhyrjet fillestare të reformave. Shembulli me këtë Ligj është ilustrues edhe për shumë ndërhyrje të tjera qeveritare sa u përket "reformave" në vitet e fundit. Një rekomandim i veçantë i Komisionit Evropian ose i organit ndërkombëtar lexohet dhe zbatohet ashtu siç i konvenon pushtetit ekzekutiv, në mënyrë që vetëm nga aspekti formal ta përmbush rekomandimin, ndërkaq në të vërtetë të ketë kontroll akoma më të madh mbi autoritetet tjera. Së këtejmi, me formimin e organeve të reja, hapen vende të reja për "strehimin" e kadrove partiake ose për joshjen e ekspertëve të rinj "të pavarur". Në këtë mënyrë, devijimet demokratike objektivist nuk rrezikohen, restaurohen dhe marrin një jetë të re, të ribrenduara rrethëm sa u përket reformave.

Ministria e Drejtësisë hapi debat për Propozim-Strategjinë për Reforma në Gjyqësor.<sup>9</sup> Operacionalizimi i masave në lidhje me pavarësinë e gjyqtarëve parashikohet në vitin 2018, dhe kjo kryesisht me ndërhyrje rregullatore dhe ndërhyrje në drejtim të përforcimit të kapaciteteve. Së këtejmi, Strategjia e propozuar në këtë aspekt kyç në të vërtetë drejtpërdrejt u kundërvihet Prioriteteve të Reformave Urgjente.<sup>10</sup> Ky është një shembull evident edhe sa i përket asaj se efekti i ndihmës para-aderuese të KE është në kundërshtim me Prioritetet e Reformave Urgjente të KE, të cilat në këtë mënyrë e minimizojnë.

<sup>5</sup>Gjatë mbikëqyrjes u përfshinë organizatat, si vijojnë: Instituti për të Drejtat e Njeriut, Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë", Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë dhe OJQ Infoqendra.

<sup>6</sup> Raportet nga mbikëqyrja janë të aksesshme në: <http://www.epi.org.mk/newsDetail.php?nwsid=89>

<sup>7</sup>Për informata më të detajuara: Analiza e Kapitullit 23: "Jurisprudenca dhe Të Drejtat Themelore në Republikën e Maqedonisë", e hartuar në kuadër të "Rrjetit 23", e aksesshme në: [http://www.epi.org.mk/docs/Analiza\\_Mreza.pdf](http://www.epi.org.mk/docs/Analiza_Mreza.pdf); Analizë: "Pavarësia e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë – synime dhe sfida", hartuar nga Instituti për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Projektit "Rrjeti 23", e aksesshme në: <http://www.ihr.org.mk/images/pub/analiza-za-ssrm-konecna.pdf>.

<sup>8</sup>Mendim në lidhje me ligjet për përgjegjësi disiplinore dhe për vlerësimin e gjyqtarëve. Komisioni Evropian për demokraci përmes të drejtës (Komisioni i Venecias). 21.12.2015. I aksesshëm në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2015\)042-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2015)042-e).

<sup>9</sup>Propozim-Strategjia është hartuar me mbështetje profesionale dhe logjistike të Projektit për përgatitjen e programit për mbështetjen e sektorit të jurisprudencës dhe Projekti IPA 2010 "Mbështetje e vazhdueshme për një gjyqësor të pavarur, të përgjegjshëm, profesional dhe efikas dhe për promovimin e dënimit me kusht dhe masave alternative".

<sup>10</sup>Instituti për të Drejtat e Njeriut përpiloi komente dhe vërejtje ndaj Propozim-Strategjisë të cilat janë të aksesshme në: [www.ihr.org.mk](http://www.ihr.org.mk)

Baza e re qendrore e paralajmëruar e të dhënave të Gjykatës Supreme në RM, përmes së cilës duhet të publikohen aktgjykimet e të gjitha gjykatave në shtet, në të ardhmen nuk do t'i përmbajë aktgjykimet e publikuara gjyqësore në ueb-faqet e veçanta të gjykatave, me çka vihet në pikëpyetje kuptimi i ndërhyrjes së këtyllë. Ky aktivitet, jo vetëm që nuk është në favor të prioritetit për publikimin në kohë të të gjitha aktgjykimeve gjyqësore, por është “i dështuar” edhe kuptimi i këtij prioriteti i cili, para së gjithash, ka të bëjë me publikimin e aktgjykimit nga ana e gjyqtarit në afatin e përcaktuar me ligj.

Nuk është vërejtur “realizimi i rolit proaktiv të Këshillit Gjyqësor dhe rritja e profesionalizmit të tij”, ndërsa nuk janë të dukshme veprime të cilat duhet të sigurojnë parashikueshmëri të mjaftueshme të përkufizimit “jurist i shquar”, (nuk mjafton vetëm stazhi prej 15 vitesh) si kusht për t'u bërë anëtar i Këshillit Gjyqësor. Kjo është baza sipas së cilës u zgjodh edhe kryetari aktual i Këshillit Gjyqësor edhe atë në mungesë të opozitës. Kryetari i Këshillit Gjyqësor, madje deklaroi se Raporti i KE përmban standarde të dyfishta lidhur me gjyqësorin.<sup>11</sup> Nga ana tjetër, vërehet një rol proaktiv i Këshillit Gjyqësor<sup>12</sup> dhe veçanërisht të Gjykatës Supreme, para së gjithash përmes pjesëmarrjes dhe organizimit të tryezave të rrumbullakëta dhe debateve. Së këtejmi, shtrohet pyetja se sa këto aktivitete të natyrës “ceremoniale”, mund të kontribuojnë në drejtim të përmbushjes së qëllimit të prioritetit – “gjyqtarët të mbrohen nga ndikimet ndaj pavarësisë së tyre”, nëse njëkohësisht vazhdojnë praktikatat e zakonshme të zgjedhjes dhe avancimit të gjyqtarëve.

Realizohet prioriteti që ka të bëjë me Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë. Në Buxhetin e vitit 2016, janë parashikuar më shumë mjete në krahasim me vitin 2014 dhe 2015.

Sa i përket sigurimit “ekzekutimit të shpejtë të të gjitha aktgjykimeve të GJEDNJ kundër shtetit”, miratimit të plan veprimeve për çdo aktgjykim dhe dërgimit të tyre pranë GJEDNJ, e që është praktikë e përhershme në RM, nuk e kënaq plotësisht kërkesën e prioritetit “zhvillimi i masave praktike dhe efektive për çdo kategori të rasteve”. Në këtë drejtim, nuk janë vërejtur masa sistematike.

Nga ana tjetër, në periudhën e kaluar janë bërë disa ndërhyrje ligjore të cilat drejtpërdrejt nuk mund të karakterizohen se janë divergjente ose konvergjente me Prioritetet e Reformave Urgjente. Një shembull i këtyllë është inkorporimi i dotacioneve të reja të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, qëllim evident i të cilave është joshja parazgjedhore dhe investimi në servilizmin e tyre ndaj urdhrave politikë. Një shembull tjetër është mundësia që bashkëpunëtorët gjyqësorë të konkurrojnë për trajnim fillestar në Akademinë e Gjyqtarëve, por vetëm si kandidat për prokurorë publikë dhe jo edhe për gjyqtarë. Nuk hasi në reagime më serioze greva paralajmëruese e punonjësve administrativ të gjyqësorit, të cilët reagues në zgjidhjet e ligjit përkatës. Kjo kategori e punonjësve të gjyqësorit është e neglizhuar, edhe pse roli i tyre është i rëndësishëm, veçanërisht në kushte kur numri i gjyqtarëve reduktohet.

**Marrë në përgjithësi, Prioritetet e Reformave Urgjente në fushën e jurisprudencës nuk zbatohen në mënyrë thelbësore. Si substitut i reformave ofrohet vetëm “ambalazhi i butë reformues”, i cili e kënaq formën por jo edhe esencën. Zbatohen vetëm disa aspekte të veçanta më shumë të karakterit teknik, të cilët kanë ndikim të kufizuar mbi pavarësinë dhe profesionalizmin e pritur. Nga ana tjetër, ndërmerren veprime që janë në kundërshtim me Prioritetet e Reformave Urgjente.**

## **B) Mbikëqyrja funksionale gjyqësore dhe parlamentare mbi ndjekjen e komunikimeve**

Deri më tani, në këtë fushë, nuk janë ndërmarrë kurrfarë hapa konkret, përveç formimit të vonuar të Komisionit Anketues për Skandalin e Përgjimeve në Kuvend. Për rezultate konkrete as që bëhet fjalë, meqë kërkesa që dëshmitarët të dëshmojnë “në seanca të mbyllura për publikun” i banalizoi pritshmëritë sa i përket procesit transparent, si dhe sa i përket katarsës së mundësuar institucionale.

<sup>11</sup> Sipas Këshillit Gjyqësor, KE ka standarde të dyfishta për gjyqësorin. Telma. 27.11.2015. E aksesshme në:

<http://telma.com.mk/vesti/za-sudskiot-sovet-ek-ima-dvojni-standardi-za-sudstvoto>

<sup>12</sup> U miratua Plan Veprimi për zgjidhjen e lëndëve të parashkruara; janë përcaktuar vizita pune tremujore të gjykatave; është miratuar sistematizimi i ri për vendet e gjyqtarëve nëpër gjykata; është miratuar vendim për shpalljen e konkursit për gjeneratën VI në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë; u miratua Rregullore e re për punë të Këshillit Gjyqësor dhe për procedura të brendshme interne.

## C) Organe të pavarura rregullatore dhe mbikëqyrëse

Nuk janë vërejtur kurrfarë veprimesh në mënyrë që në praktikë të sigurohet autonomia e organeve të pavarura rregullatore dhe mbikëqyrëse dhe profesionalizmi i anëtarëve të tyre.

Nuk zbatohen as prioritetet për respektimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe avancimin e zgjidhjeve ligjore në mënyrë që të harmonizohen me Deklaratën e Parisit. Madje, Avokati i Popullit deklaroi se has në pengesa nga pushteti ekzekutiv në ushtrimin e funksionit të tij.<sup>13</sup> Ky lloj i “dekapitacionit” institucional, kur disa organe të caktuara funksionojnë me minimumin operativ, ndërkaq udhëheqësit e tyre në praktikë ballafaqohen me pengesa gjatë kryerjes së kompetencave të tyre, nuk ka dimensione endemike por dimensione epidemike

## C) Politikat dhe legjislacioni i antikorrupsionit

Përveç dosjes të cilën e zhvillon Prokurori Publik Special,<sup>14</sup> nuk ka hapa të dukshëm të luftës kundër profilit më të lartë të korrupsionit. Përkundrazi, edhe më tutje haset në rezistencë për hapjen dhe përfundimin e lëndëve të këtitilla.

Nuk është themeluar as Regjistri Qendror i punonjësve të cilët i nënshtrohen kontrollit të konfliktit të interesave dhe deklarimit të pronës – prioritet ky i cili përsëritet vite me radhë.

Pika e vetme e realizuar nga dosja antikorrupsion është Ligji për denoncuesit. Edhe miratimi i këtij Ligji u shoqërua me kontroversa – në pako me Ligjin për mbrojtjen e privatësisë propozimi fillestar i të cilit, i propozuar nga koalicioni qeveritar, përmbante elemente të censurës. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit funksionon si qëllim për vetveten. Ky Komision, vitin 2015, “e shënoi” vetëm me disa komunikata, prej të cilave shumica për punëtori dhe seminare të organizuara dhe me një jotransparencë ndaj mediave, përkatësisht ndaj publikut.

## D) Lustrimi

Qeveria e shënoi ndërprerjen e Ligjit për lustrim si prioritet të realizuar. Megjithatë, mbeten 38 lëndë aktive para Komisionit dhe 38 lëndë para Gjykatës, si dhe lëndët të cilat janë para GJEDNJ.<sup>15</sup>

## II DEPOLITIZIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Nëse realizimi i prioritetit ndërlidhet me hyrjen në fuqi të ligjeve të reja, atëherë kjo është një qasje krejtësisht e gabuar. Është fakt se vazhdon politizimi i administratës publike. Nga ana tjetër, Qeveria në mënyrë të qartë e bëri me dije se nuk e ka ndërmend t'i vë moratorium Ligjit për transformimin e punësimeve të përkohshme në të përhershme, ashtu siç e kërkon KE në njërin nga prioritetet konkrete të dokumentit. Në drejtim të kundërt, vazhdoi me këtë aktivitet.

Përfundimisht, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës e publikoi numrin e përgjithshëm të të punësuarve në sektorin publik, të cilin vite me radhë e kërkonte edhe publiku vendor por edhe Komisioni Evropian - 128.253. Megjithatë, ministri paralajmëroi “themelim të plotë të Regjistrimit dhe hartimin e raportit të parë vjetor në muajin shkurt të vitit 2016”, e që vetvetiu nënkupton një distancim të caktuar për të dhënat e publikuara.

<sup>13</sup> Ixhet Memeti: DSK dhe Prokuroria Publike më pengojnë në hetimin e përgjimeve. 24 Vesti. 15.09.2015. E aksesshme: <http://24vesti.mk/izet-memeti-ubk-i-javnoto-obvinitelstvo-me-sprechuvaa-da-go-istrzhuvam-prislshuvanjeta>.

<sup>14</sup> Sipas emërimit ligjor, Prokuror Publik për Ndjekjen e Veprave Penale të ndërlidhura dhe të cilat rezultojnë nga përmbytja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve.

<sup>15</sup> Nga mbikëqyrja e Institutit për të Drejtat e Njeriut.



## III REFORMA ZGJEDHORE

Hapat e deritanishëm, edhe pse morën shumë kohë në procesin e negociatave midis partive, vështirë mund ta arsyetojnë titullin ambicioz të fushës prioritare. Reformat, thënë në mënyrë të butë, janë – joambicioze, ndërsa në negociatat ndërpartiake dështoi mundësia për së paku inkorporimin e listave të hapura.

Problem më të madh paraqet revizioni dhe Lista e Zgjedhësve, e cila “azhurnohet” disa vjet, por pa kurrfarë rezultatesh.

Ky është prioriteti i cili gjithsesi se duhet të realizohet deri në zgjedhjet e parakohshme për të cilat kanë rënë dakord, ndërkaq gjithnjë e më shumë bëhet e qartë se nuk ka kohë për realizimin e tyre, veçanërisht jo për revizionin e Listës së Zgjedhësve.

## IV IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT ANKETUES PËR NGJARJET E 24 DHJETORIT

Mosimplementimi i këtij prioriteti është tregues për mosekzistimin e vullnetit politik që të punohet në drejtim të sigurimit të balancit midis pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës.

## V MEDIA: LIRIA E SHPREHJES

Negociatat për mediat janë në rrugë pa krye, ndërsa partitë akuzohen midis tyre për gjendjen e këtillë. Shoqata e Gazetarëve (SHGM) dhe Instituti Maqedonas i Mediave (IMM) dolën me kërkesë që të përfshihen në negociata.

### a) Servisi publik radiodifuziv

Nuk janë zbatuar reforma në servisin publik radiodifuziv. Përkundrazi, mbikëqyrjet e zbatuara ndaj mediave vënë në dukje shkeljen e rregullave të gazetarisë objektive nga ana e Radiotelevizionit Maqedonas.

### b) Reklamimi i Qeverisë

Qeveria në mënyrë të njëanshme paralajmëroi se do t'i ndërpres reklamata e paguara në mediat elektronike. Megjithatë, kjo nuk e nënkupton edhe zbatimin esencial të prioriteteve të cilat kërkojnë zgjidhje sistematike – vendosje të rregullave dhe transparencës sa i përket reklamimit të paguar, si dhe mekanizmit për shpallje pa pagesë. Megjithatë, mungesa e reklamave me pagesë, në mënyrë subtile kompensohet përmes formave gazetareske “të informimit”, drejtpërdrejt në programet informative, në pikun e shikueshmërisë.

### c) Aksesit në informata

Nuk ka ndryshime të dukshme sa i përket aksesit të gazetarëve deri te informatat.

### ç) Shpifja

Nuk ka iniciativa për ndryshimin e Ligjit për përgjegjësi qytetare nga shpifja në lidhje me përkufizimet (harmonizimin me nenin 10 të KEDNJ), ndërkaq nuk ka as ndryshime të rregullave procedurale për përjashtimin e rasteve me vlerë të vogël dhe përdorimin e meditacionit, ashtu siç sugjerojnë Prioritetet e Reformave Urgjente.

Analiza e lëndëve lidhur me shpifjen nuk vë në dukje se politikanët janë vetë-kufizuar në ngritjen e padive për shpifje në krahasim me vitin paraprak. Nga qershori janë ngritur 8 lëndë të reja në të cilat si palë është gazetari, ndërkaq seancat gjyqësore janë caktuar për 24 lëndët rrjedhëse.<sup>16</sup>

<sup>16</sup> Nga mbikëqyrja e OJQ Infoqendra.

## Çka është e rëndësishme, ndërkaq në mënyrë eksplicite nuk është cekur në Prioritetet e Reformave Urgjente?

Njëri nga rreziqet e vendosjes së rekomandimeve konkrete, të cilat Qeveria duhet t'i përmbush në kuadër të "agjendës evropiane", për shkak të fokusimit mbi të njëjtat, është të mos vërehen proceset dhe ngjarjet të cilat vënë në dukje probleme të tjera madje edhe më të mëdha.

Për Republikën e Maqedonisë, diagnoza më kritike është ajo që ka të bëjë me kontrollin partiak mbi institucionet. Krahas asaj që është tentuar Prioritetet e Reformave Urgjente të formulohen në atë mënyrë që të kontribuohet në reduktimin e tyre, përkatësisht të evitohen influencat partiake mbi institucionet, në të vërtetë ato nuk mund të parashikojnë çdo gjë. Kështu, për shembull, emërimi i anëtarëve të Këshillit për Akreditim të institucioneve të arsimit të lartë,<sup>17</sup> të cilët për publikun janë të njohur si të afërt me partitë në pushtet, është një indikator i qartë se partitë në pushtet nuk kanë vullnet politik për të hequr dorë nga influenza partiake, por përkundrazi – vazhdojnë me strategjinë e kontrollit partiak mbi institucionet. Një shkelje akoma më e drejtpërdrejt është propozimi i anëtarëve të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi të cilët nuk i plotësojnë kushtet që të bëhen anëtarë të këtij Komisioni, propozimin e të cilëve e bëri koalicioni në pushtet, ndërkaq e kundërshtoi partia opozitare LSDM.

Nga ana tjetër, fushata zgjedhore tanimë është në vllug e sipër – paralajmërimet për rritjen e asistencës sociale, pensioneve, subvencioneve etj. kanë jehonë gjithnjë e më të madhe nga Prioritetet "e mërzitshme" të Reformave Urgjente, veçanërisht përmes mediave të cilat edhe më tej kontrollohen fuqishëm, si dhe përmes hapjes së mediave të reja, si logjistikë rezervë për qëllime politike dhe zgjedhore.

Përveç kësaj, duhet të merret parasysh "fluiditeti" i rekomandimeve nga institucionet e komisionit Evropian. Këtu, veçanërisht duhet të merren parasysh konkluzionet e këshillit të BE-së nga muaji dhjetor i vitit 2015, si dhe rekomandimet e Raportit të KE për Republikën e Maqedonisë për vitin 2015. Përveç mbështetjes së Prioriteteve të Reformave Urgjente, Këshilli i adreson/përsëritë këto rekomandime:

- Hetim i plotë i ngjarjeve në Kumanovë nga data 9/10 maj të vitit 2015, në mënyrë objektive dhe transparente;
- Përfundimi i analizës së Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe implementimi i rekomandimeve të saj; – Përforcimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore; shmangia e veprimeve të cilat mund t'i pengojnë; zgjidhja e çështjes së emrit.

17 Aktvendim për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Akreditimin dhe Evaluimin e Arsimit të Lartë. "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 220/15 nga data 15.12.2015. I aksesshëm në:

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/45fa8ed02be04097803bb8884e2fcace.pdf>.

Komisioni Evropian e plotëson dosjen me masa konkrete që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar. Këtu, veçanërisht janë të rëndësishme rekomandimet për pastrim parash dhe për formimin e Qendrës.<sup>18</sup> Plotësimet e tjera kanë të bëjnë me miratimin e strategjive dhe plan veprimeve për reformën e gjyqësorit dhe administratës publike dhe përforcimin e kapaciteteve për planifikim strategjik të gjyqësorit.

Pa u shqetësuar, Qeveria i injoroi rekomandimet të cilat janë më shumë të karakterit politik, ndërsa ndërmerr masa vetëm për ato rekomandime që janë më shumë të karakterit teknik dhe të cilat i mundësojnë të "blejë kohë". Çështja e hetimit të ngjarjeve të Kumanovës tanimë një kohë më të gjatë është shmangur nga rendi i ditës.

Nga ana tjetër, analiza e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit ka ngecur, pas distancimit të VMRO-DPMNE nga kjo analizë.<sup>19</sup>

Sa u përket marrëdhënieve të mira fqinjësore, dy takimet e ministrave të Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë – në Shkup dhe në Athinë, ishin të mjaftueshme që të plotësohet dosja e aktiviteteve, por jo edhe të arrihet një hap përpara në zgjidhjen e çështjes së emrit / për çka Republika e Maqedonisë aktualisht nuk është në kondicion dhe pozitë të mirë.

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Prioritetet e Reformave Urgjente nuk zbatohen në mënyrë thelbësore, madje as që bëhet fjalë për "implementimin e tyre të konsiderueshëm".

– Monitorimi i realizimit të Prioriteteve të Reformave Urgjente është josistematik dhe i pamjaftueshëm, si nga ana e institucioneve vendore ashtu edhe nga ana e institucioneve të huaja. Primatin gjatë monitorimit e merr implementimi i pikave tjera të Marrëveshjes së Përzahinos, kështu që Prioritetet e Reformave Urgjente janë neglizhuar plotësisht.

– Mungon transparenca në lidhje me masat e planifikuara dhe zbatuara nga ana e Qeverisë.

– Mungon transparenca në lidhje me konstatimet e Komisionit Evropian, sa i përket implementimit të Prioriteteve të Reformave Urgjente.

– Është e domosdoshme të inkorporohet mekanizëm, i cili do ta mundësojë llogaridhënien në lidhje me implementimin e Prioriteteve të Reformave Urgjente, në të cilin do të përfshihen Komisioni Evropian, Qeveria dhe Kuvendi i RM-së, organet relevante të pavarura dhe shoqëria civile.

– Nevojitet urgjentisht, brenda mundësive edhe përmes dialogut të lartë aderues, të përcaktohen afate reale dhe indikatorë për implementimin e Prioriteteve të Reformave Urgjente. Ky veprim duhet të zbatohet në mënyrë të strukturuar, sipas fushave tematike, me pjesëmarrjen e organeve të pavarura, si dhe të sektorit civil.

<sup>18</sup> Rekomandime në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar:

– vendosja e dosjes për luftë kundër pastrimit të parave dhe avancimit të kapaciteteve dhe ekspertiza për zbatimin e hetimeve financiare dhe mjetet për konfiskimin në bazë më sistematike;

– përforcimi i angazhimeve për përmirësimin e bashkëpunimit midis agjencive të ndryshme për zbatimin e ligjit përmes aftësimin të plotë të Qendrës Koordinative Nacionale për Luftë Kundër Krimit të Organizuar;

– revidimi i kornizë ligjore dhe teknike për ndjekjen e komunikimeve dhe rritja e efektivitetit të masave speciale hetuese për zbatimin e mirëfilltë të qëllimeve të Ligjit (Prioritetet e Reformave Urgjente).

<sup>19</sup> VMRO-DPMNE distancohet tërësisht nga analiza e Marrëveshjes Kornizë. Alsat-M. 9.12.2015. E aksesshme në: <http://alsat.mk/News/225526/vmro-dpmne-celosno-se-distancira-od-analizata-na-ramkovniot-dogovor>.

Prioritetet e Reformave Urgjente  
më të ngadalshme se restaurimi  
i praktikave joreformuese!



Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup